AKTUALITET

Masakër në Elbasan! Vritet Pjerin Xhuvani, mbështetësi i PS-së u përplas me SMV, dyshohet se po shpërndante para për votat. Plagosen 4 persona. Ish-efektivi i RENEA-s pranon krimin (NGJARJA-EMRAT)

VIDEO

Masakra/ Meta: Tensioni vjen nga Rama, ka tmerr zgjedhjet e lira
Si e komentonte Rama sherrin e Pjerin Xhuvanit më 14 mars, nuk i kurseu ofendimet
Klodiana Lala jep detaje: PD-ja dha alarmin se Xhuvani po shpërndante lekë për vota
DINAMIKA: Kapën makinën me para, përleshja me armë në sytë e nëndrejtorit të policisë
MASAKRA E ELBASANIT s'i bën përshtypje Ramës: Dëshpërimi i humbësve!
Balla drejton gishtin nga PD: Sollën furgona me paramiliatarë të armatosur
Ambasada amerikane THIRRJE palëve: Tregoni vetëpërmbajtje!
BE në Shqipëri: Të hetohet me shpejtësi

Përgjaket Elbasani! Një masakër ka ndodhur 100 metra larg zyrës elektorale të lagjes nr.5 të qytetit, ku është qëlluar për vdekje Pjerin Xhuvani. Ndërkohë që të plagosur kanë mbetur 4 persona të tjerë; Emiljan Prenga 39 vjeç, person me precedent penalë; Pavlo Vuksani 50 vjeç, ish-efektiv i policisë kriminale; Eltjon Bodinaku 32 vjeç (dhëndrri i viktimës) si dhe efektivja e forcave "Shqiponja", Xhensila Sota 27 vjeçe.



Pjerin Xhuvani, Emiljan Prenga, Pavlo Vuksani, Arbër Papleka dhe pamjet nga vendi i ngjarjes

21 Prill, 2021 14:25

ELBASAN– Pjerin Xhuvani, 56 vjeç, i njohur si mbështetës i Partisë Socialiste dhe ish-drejtori i Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është ekzekutuar sot me armë zjarri. Dosja.al ka mësuar se Xhuvani ka marrë tre plumba në trup, por ai pranë zemrës i mori jetën dhe e la të vdekur. Ngjarja e rëndë që ka marrë tashmë dhe emrin "Masakra e Elbasanit", la pas edhe katër persona të plagosur. Ata janë: ish-polici Emiljan Prenga 39 vjeç, person me precedent penalë; Pavlo Vuksani 50 vjeç, ish-efektiv i policisë kriminale; Eltjon Bodinaku 32 vjeç (dhëndrri i viktimës) si dhe efektivja e forcave "Shqiponja", Xhensila Sota 27 vjeçe.

Të katër të plagosurit ndodhen në spitalin e Traumës, ku po marrin mjekimin e nevojshëm që por Bodinaku dhe Prenga janë në gjendje të rëndë për jetën. Ish-efektiv Prenga ka marrë një plumb në kohë, ndërsa Bodinaku ka hematoma të mëdha në pjesën e kohës dhe plagë të shkaktuar nga një armë zjarri në pjesën e kraharorit.

STAY CONNECTED
Facebook LIKE
Twitter FOLLOW
Instagram FOLLOW
Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT

22 Prill, 2021 0:03

U arrestuan LIVE! Djemtë e prangosur në Elbasan janë përfshirë në sherrin e 14-Marsit, sonte u futën në zonën e rrethuar

21 Prill, 2021 23:58

Artan Hoxha jep 'alarme të forta': Ajo që pamë në Elbasan, mund të ndodhë në Shkodër e Vlorë! Fevziu: Mos se ti e ke gojën helm...

21 Prill, 2021 23:50

Fratari viziton lagjet e Tiranës: Të gjithë

Si ndodhi e gjithë ngjarja?

Gjithçka nisi pasi shtabi elektoral i Partisë Demokratike kishte ndaluar një makinë, pasi dyshonte se personat që ndodheshin brenda saj, Pjerin Xhuvani dhe Mehmet Dafllaku po shpërndanin para në këmbim të votës. Anëtarët e PD-së kanë kërkuar që të kontrollojnë mjetin, ndërsa Xhuvani nuk ka pranuar. Kjo gjë ka sjellë përplasjen fizike me palëve. Të alarmuar nga ajo që po shikonin, banorët e zonës kanë lajmëruar policinë, por përpara uniformave blu, në vendin e ngjarjes kanë mberritur mbështetësit dhe njerëzit e Xhuvanit, që siç deklaroi më edhe Gazment Bardhi, ishin me makina të blinduara. Ata ishin të armatosur dhe qëlluan drejt shtabit të PD-së e pjesëtarëve të Strukturës për Mbrojtjen e Votës.

I pari që ka qëlluar rezulton të jetë Kelmend Xhaferri, i cili tashmë është shpallur në kërkim dhe akuzohet për pjesëmarrje në këtë masakër, pasi la të plagosur dy ishefektivët Prenga e Vuksani. Pala e Strukturës për Mbrotjen e Votës është kundërpërgjigjur dhe ka qenë ish-efektivi i forcave RENEA, Arbër Papleka ai që ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar. Përplasja me armë zjarri ka vijuar, duke lënë kështu të vdekur Xhuvanin, duke plagosur dhëndrrin e tij, Bodinaku dhe efektivë Sota. Kjo e fundit bashkë me gruoin efektivëve të forcave "Shqiponja" ishin të pranishëm në momentin që ndodhi e gjitha masakra që përgjaku këtë fushatë zgjedhore.

Menjëherë pas krimit, ka qenë vetë Pepkola ai që është dorëzuar në polici. 36-vjeçari, një ish-efektivi i forcave RENEA dhe baba i katër fëmijëve 'u zhduk' nga skena e krimit, mori makinën e një qytetari dhe udhëtoi drejt Tiranës. Ai u fut në zyrën e komandantit të forcave RENEA, dorëzoi armën e zjarrit dhe u deklarua fajtor për vrasjen e Xhuvanit, duke u vënë më pas në pranga. Në dëshminë e tij, Pepkola ka thënë se ka qëlluar për vetëmbrojtje, pasi është ndjerë i kërcënuar për jetën ng apala përballë.

Hetimet për ngjarjen janë në vijim e sipër, por kjo masakër ka hapur një valë reagimesh në palët politike. Presidenti Ilir Metqa u tregua i prerë kur tha se nuk kishte asnjë koment për krimin e kryer, por që kërkonte zbardhjen e tij sa më shpejt. Kryeministri Edi Rama tha se kriminelët në këtë rast ishin ata të Partisë Demokratike pasi Pepkola ishte pjesë e skuadrës së tyre. Vetë Gazment Bardhi mohoi që Papleka të ishte truporoja e tij, por shtoi se ai ka reaguar pasi është qëlluar me armë zjarri nga pala e viktimës, Pjerin Xhuvani.

Ndërkombëtarët e kanë dënuar këtë krim të rëndë, dhe kanë bërë thirrje për zbardhjen e saj e për vënien e autorëve përballë drejtësisë. Gjithashtu ambasadorët kanë kërkuar përmbajtje nga liderët politikë.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, **Dosja.al**

Kush ishte Pjerin Xhuvani?

Pjerin Xhuvani është i njëjti person i cili u përfshi në sherrin mes mbështetësve të Partisë Demokratike dhe asaj Socialiste në Elbasan Ditën e Verës. Xhuvani ka qenë disa vite më parë drejtues i Lëvizjes Socialiste për Integrim, ndërsa tashmë në vitet e fundit ishte angazhuar pranë Partisë Socialiste. Xhuvani ka qenë ish- drejtor në Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, dhe është prangosur 6 vite më parë pasi akuzohej se i shkaktoi dëm rreth 56 milionë lekë të reja shtetit. Më 14 mars ai ishte pjesë e turmës që goditi mbështetësit e PD të cilët thërritën Rama ik gjatë parakalimit të kryeministrit Edi Rama.

Kush është Arbër Papleka?

Arbër Papleka, i cili tashmë ndodhet pas hekurave si autor i masakrës së ndodhur në qytetin e Elbasanit ka qenë efektiv i forcave RENEA. 36-vjeçari, babai i katër fëmijëve, me origjinë nga Tropoja, ka qenë shef i njësisë së posaçme në policinë e shtetit në Tiranë dhe efektiv i forcave RENEA. Në vitin 2018, Papleka u shkëput nga forcat RENEA dhe u zgjodh si pjesë e grupit të sigurisë nga stafi i Ambasadës Amerikane në Tiranë. Papleka u bë pjesë e një konkursi të cilin e fitoi pasi kishtë një përgatitje shumë të mire. Më pas, ai u bë pjesë e grupit të Strkturës për Mbrojtjen e Votës në Elbasan.

Kush është Emiljan Prenga?

Emiljan Prenga, një nga katër personat që mbetën të plagosur në masakrën e Elbasanit që trondíti vendin mesditën e sotme ka qenë gjithashtu një efektiv policie. Prenga rezulton të jetë vënë në pranga në muajin nëntor të vitit 2016, pasi i ka bërë presion një personi me inicialet K.P., për t'i dhënë 11 mijë euro. Ky kërcënim erdhi pas prishjes së pazareve të drogës mes Prengës dhe personit tjetër, me inicialet K.P.. Konkretisht ky i fundit kishte porositur 50 kg kanabis në Krujë me vlerë 550 euro për një kilogram për një mikun e tij në Durrës. Në momentin që droga nuk shkoi në Itali, në destinacionin që duhej të shkonte, Prenga nisi kërcënimet drejt personit me inicialet K.P..

Kush është Pavlo Vuksani?

janë me shpresën për ndryshim në 25 prill

21 Prill, 2021 23:49

"Jam i gatshëm të përballem", Klodiana Lala tregon telefonatën me të shpallurin në kërkim, çfarë i tha Kelmend Xhaferri

Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

Pavlo Vuksani ka qenë punonjës i policisë kriminale. Dosja.al ka mësuar se më 19 shkurt të vitit 2013, Vuksani ka rënë pre e një atentati me eksploziv. Artan Koçeku dhe dy vëllezërit Nikolin dhe Marjan Thani kanë vendosur eksploziv makinës së ish-efektivit Vuksani, në lagjen "Skënderbeg", në qytetin e Shkodrës. Ishte një operacion i koduar "Pikat e karburanteve", që solli zbulimin dhe arrestimin e autorëve, të cilët veç vendosjes së eksplozivit ndaj automjetit të oficerit të Policisë Vuksani kanë kryer grabitjen e 8 pikave të karburantit në zonën e Shkodrës dhe të Lezhës, vjedhjen e 12 dyqaneve (kryesisht televizorë "Plazma"), si dhe të 2 automjeteve.nga atentati në fjalë, Vuksani nuk mbeti i plagosur pasi nuk ishte në mjet në momentin që shpërtheu lënda plasëse.

(k.m;f.g/dosja.al)

18:15 - **I mbuluar i gjithi me çarçaf të bardhë! MOMENTI kur sillen tek Trauma të plagosurit e masakrës së Elbasanit, përveç infermierëve, kanë me vete edhe policë…**

Mbërrijnë në spitalin e Traumës dy nga të plagosurit e masakrës së Elbasanit, Eltjon Bodinaku dhe Pavlin Vuksani. Të dy janë sjellë me emergjencë në Tiranë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore që i kanë shkaktuar plumbat e marrë gjatë përplasjes me armë zjarri në një prej zonave më të frekuentuara të qytetit.

Nuk dihet ende se si është gjendja e tyre shëndetësore, por deri më tani është bërë me dije se jashtë rrezikut për jetën është vetëm efektivja Xhensila Sota, e cila është plagosur në këmbë.

17:23 - **E plagosur në këmbë! PAMJET e efektives së "Shqiponjave" nga spitali, e fashuar dhe me gjak…doktori ia shikon nga afër**

Dalin pamjet e efektives së forcave "Shqiponja", Xhensila Sota e cila ka mbetur e plagosur në masakrën e Elbasanit. Ajo është vizituar në spital nga drejtuesi politik i qarkut të Elbasanit, Taulant Balla.



Siç duket nga pamjet, policja është qëlluar me armë zjarri në këmbë dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Megjithatë është nën kujdesin mjekësor.

17:17 - Ngjarja në Elbasan, Hajdari e revoltuar: Është një vrasje politike

Kandidatja për deputete në Elbasan Rudina Hajdari ka shkuar në lagjen "5 maj" ku dhe ndodhi masakra që la të plagosur 4 persona dhe të vrarë Pjerin Xhuvanin. Hajdari një një prononcim për mediat e quajti këtë një vrasje politike. Hajdari tha se kjo ngjarje është e frymëzuar nga bandat politike, që kërkojnë të vjedhin votat e qytetarëve.

"Sot në Elbasan ka ndodhur një ngjarje shumë e rëndë, është një vrasje politike. Është një gjë për t'u shqetësuar, unë po mundohem të informohem me Ardi Veliun mbi këtë ngjarje. Ajo që është e patolerueshme është se kjo ngjarje është e frymëzuar nga bandat politike që duan të marrin votat e qytetarëve me armë, me lekë. Ajo çka di unë është që kjo ngjarje është e frymëzuar 100% nga prapaskenat politike. Këta janë në gjendje të bëjnë çdo gjë për të marrë votat, janë në gjendje të vrasin njerëz për një apo dy mandate politike. Qyteti i Elbasanit është damkosur sot si qyteti i bandave, dhe për këtë duhet të fajësojmë plitikën," tha Hajdari.

16:59 - Mori plumbin në Masakrën e Elbasanit, kush është Pavlo Vuksani, ish-punonjësi i policisë kriminale që i vunë tritol në vitin 2013, pas eksplozivit fshihej Tan Koçeku i Shkodrës



Pavlo Vuksani një nga katër personaqë mbetën të plagosur mesditën e sotme në Elbasan ka qenë punonjës i policisë kriminale. Dosja.al ka mësuar se më 19 shkurt të vitit 2013, Vuksani ka rënë pre e një atentati me eksploziv. Artan Koçeku dhe dy vëllezërit Nikolin dhe Marjan Thani kanë vendosur eksploziv makinës s ëish-efektivit Vuksani, në lagjen "Skënderbeg", në qytetin e Shkodrës.

Ishte një operacion i koduar "Pikat e karburanteve", që solli zbulimin dhe arrestimin e autorëve, të cilët veç vendosjes së eksplozivit ndaj automjetit të oficerit të Policisë Vuksani kanë kryer grabitjen e 8 pikave të karburantit në zonën e Shkodrës dhe të Lezhës, vjedhjen e 12 dyqaneve (kryesisht televizorë "Plazma"), si dhe të 2 automjeteve.

Koçeku dhe Thani u vunë në pranga një muaj pasi vendosën eksplozivin. Nga shpërthimi nuk ka pasur të lënduar, por vetëm dëme materiale, fatmirësisht. Sot, në rrethana ende të paqarta, Vuksani mbeti I plagosur në masakrën e Elbasanit. Ai ndodhet në spital, jashtë rrezikut për jetën.

16:26 - Masakra në Elbasan, policia nxjerr njoftimin zyrtar: Janë plagosur 4

persona, autori është Paplekaj

Policia e Elbasanit ka publikuar njoftimin zyrtar, kur kanë kaluar më shumë se tre orë nga Masakra e Elbasanit, ku u vra Pjerin Xhuvani. Në njoftimin zyrtar thuhet se kanë mbetur të plagosur katër persona, Emiljano Prenga, Pavlo Vuksani, Eltjon Bodinaku dhe efektivja Xhensila Sota. ndërsa në pranga si autor për krimin e rëndë është vënë Arbër Pepkola, ish-efektiv i forcave RENEA.

Elbasan/Informacion paraprak

Më datë 21.04.2021, rreth orës 14:00, në lagjen "5 Maji", Elbasan, gjatë një konflikti është vrarë me armë zjarri shtetasi P. XH., si dhe janë plagosur shtetasit E. P., P. V. dhe E. B. Gjithashtu, në përpjekje për të parandaluar krimin është plagosur edhe punonjësja e Policisë e forcës së posacme "Shqiponjat", XH. S. Menjëherë në ndihmë të patrullës kanë shkuar shërbime të tjera të Drejtorisë Vendore dhe të Komisariatit të Policisë Elbasan, si dhe janë ngritur pika kontrolli në të gjitha akset rrugore në hyrje dhe dalje të qytetit të Elbasanit.

Gjithashtu, menjëherë është ngritur një grup i posaçëm hetimor i përbërë nga specialistë të hetimit të krimeve kundër personit në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, të Drejtorisë sē Krimeve Kundēr Personit e Pasurisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan po vijon intensivisht puna për fiksimin dhe administrimin e çdo prove materiale që do t'i shërbejë zbardhjes dhe dokumentimit të ngjarjes. Ndërkohë janë shoqëruar në Drejtoritë Vendore të Policisë Elbasan dhe Tiranë, disa persona të dyshuar se kanë dijeni apo lidhje me ngjarjen, si dhe është bërë e mundur vënia në pranga e autorit të vrasjes, shtetasi A. P., ish punonjës police. Vijon puna për kapjen dhe arrestimin e personave të tjerë të përfshirë në ngjarje.

16:12 - FOTOT NJË MË NJË! Kjo është makina ku ishin fshehur paratë dhe kartat e identitetit, BENZ i zi me targa 010. Është e rrethuar nga ekspertët

Dalin pamjet nga makina ku thuhet se ishin fshehur kartat e identitetit dhe paratë. Siç duket edhe nga pamjet, viktima Pjerin Xhuvani po qarkullonte në një mjet tip "Benz", me tagra AA010CC.

Mjeti është rrethuar nga ekspertë të kriminalistikës, ndërsa po kontrollohet me detaje për çdo shenjë që mund të zbardhë dinamikën e ngjarjes.

15:56 - "Na qëlluan të parët", zbardhet dëshmia e ish-oficerit të RENEA-s, Arbër Papleka: Shtiva për vetëmbrojtje!

Arbër Papleka, autori i vrasjes së Pjerin Xhuvanit pas dorëzimit në Polici ka rrëfyer se ka qëlluar për vetëmbrojtje. Burime për ***Dosja.al*** bëjnë me dije se Paplekaj mësohet se ka thënë se personat që po lëviznin me makinën me para dhe karta identiteti kanë qëlluar me arme ndaj tyre, pasi i kanë ndaluar për ti denoncuar në polici. Ai nuk ka pranuar që të ketë qëlluar me dashje ndaj viktimës dhe të plagosurve duke rrëfyer se e gjitha ka filluar pas një denoncimi për shpërndarje parash.

"Ne shkuam për ti ndaluar se morëm një denoncim që një makinë shpërndante para. Shkuam për ti ndaluar por ata qëlluan me armë zjarri ndaj nesh",-është shprehur autori.

15:38 - **Masakra e Elbasanit, kush është ish-oficeri i RENEA-s që akuzohet se vrau Pjerin Xhuvanin, pjesë e shtabit elektoral të PD në Elbasan**



Pjerin Xhuvani, dhe ish-oficeri Arbër Papleka

Arbër Papleka, 34 vjeç nga Tropoja është larguar prej 2 vitesh nga forcat policore RENEA dhe tashmë është arrestuar është pjesë e shtabit të Partisë Demokratike në Elbasan.

Ndërsa drejtuesi politik i qarkut Elbasan Gazment Bardhi, deklaroi se ngjarja e rëndë është tregues se Shtabi elektoral i PS është i lidhur me krimin, një tjetër version vjen nga terreni.

Arbër Paplekaj, autori i vrasjes së Pjerin Xhuvanit sipas dëshmitarëve ka dalë nga një furgon me logon e PD dhe ka qëlluar për me breshëri plumbash mbi Pjerin Xhuvanin, dhëndrrin e tij dhe bashkë me të, plumbat kanë zënë edhe një police dhe një qytetar.

15:13 - **Vrasja e Pjerin Xhuvanit në Elbasan/ Vetëdorëzohet autori i dyshuar, Arbër Papleka**

Është vetëdorëzuar autori i dyshuar i krimit të rëndë në Elbasan. Ish-efektivi i Renea-s, Arbër Papleka dyshohet se është autori i vrasjes së Pjerin Xhuvanit në Elbasan. 34-vjeçari me origjinë nga Tropoja, dyshohet se qëlloi me armë zjarri ndaj Xhuvanit me 20 plumba.

15:21 - **FOTOT/ Ekzekutimi i Pjerin Xhuvanit në Elbasan, Ardi Veliu në vendngjarje**

Në Elbasan kanë mbërritur forcat RENEA, Ardi Veliu dhe Tonin Vocaj. Ata ndodhen në vendin ku u ekzekutua Pjerin Xhaferri, 54-vjeçari i cili u qëllua me armë zjarri nga ish-efektivi i forcave RENEA, Arber Papleka nga Tropoja.

15:12 - Publikohet FOTOJA/ Kjo është efektivja e "Shqiponjave" që mbeti e plagosur në Elbasan

Xhensila Sota

Personi që shikoni në foto është Xhensila Sota, efektive e forcave "Shqiponja" në qarkun e Elbasanit. *Sota ishte sot e pranishme në* lagjen "5 maji", aty ku pas një përplasjeje me armë zjarri, mbeti i vrarë Pjerin Xhuvani.

15:11 - EMRI/ Nga Tropoja, 34 vjeç dhe ish-oficeri i RENEA-s, kush është i dyshuari si autor i vrasjes së Pjerin Xhuvanit në Elbasan

Ish-efektivi i Renea-s, Arbër Papleka dyshohet se është autori i vrasjes së Pjerin Xhuvanit në Elbasan. 34-vjeçari me origjinë nga Tropoja, dyshohet se qëlloi me armë zjarri ndaj Xhuvanit me 20 plumba.

15:08 - FOTO/ Momenti kur ish-oficeri i RENEA-s qëllon për vdekje Pjerin Xhuvanin... Pika që hapi alarmin, një makinë që shpërndante lekë

Një foto e shpërndarë nga Top Channel tregon ish-oficerin e RENEA-s, Arbër Papleka, teksa qëllon Pjerin Xhuvanin. Në foto shihet momenti kur Papleka qëndron para derës së makinës me një armë zjarri në dorë.

Ai ka qëlluar Xhuvanin duke e lënë të vdekur dhe ka plagosur 3 persona të tjerë. Autori është vetëdorëzuar në polici, ndërsa ende nuk është zbardhur ngjarja plotësisht.

15:06 - Vrasja e Pjerin Xhuvanit në Elbasan, shoqërohen në polici disa persona

Disa persona janë shoqruar në polici, vetëm pak minuta pas krimit të rëndë që tronditi Elbasanin mesditën e sotme, *ku i vrarë mbeti Pjerin Xhuvani*. Ende nuk dihet identiteti i të shoqëruarve në komisariat, apo roli i tyre në këtë krim të rëndë.

15:07 - LIDHJA/ Sot u vra me 20 plumba, në 2014, Pjerin Xhuvani i dha raport fals

djalit të aktores Luiza Xhuvani, Konstandini ia hodhi "pa lagur" falë një manipulimit të drejtorit të spitalit



Pjerin Xhuvani dhe Konstantin Xhuvani

Pjerin Xhuvani, 56 vjeç është vrarë sot në rrethana të panjohura në një makinë të mbushur me para dhe karta identiteti, ndërsa përveç përplasjes së 14 marsit, ai u bë personazhi kryesor në media, disa vite më parë, për arrestimin në skandalin e rimbursimeve, por edhe për një dëm të konsiderueshëm financiar.

Pjerin Xhuvani, ish-drejtor dhe anëtar i LSI-së në vitin 2014, u lakua në çështjen e Kostandin Xhuvanit, djalit të deputetes së PS, Luiza Xhuvani, që u arrestua me akuzën e katër vrasjeve. Lakimi i tij në atë kohë u bë pasi drejtori i deri djeshëm në Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, kishte qenë për disa kohë drejtor i spitalit Psikiatrik të Elbasanit.

Ishte pikërisht ky spital që lëshoi një vërtetim, sipas të cilit, Kostandin Xhuvani ishte paraqitur aty në gjendje të alkoolizuar dhe ishte mjekuar, në të njëjtën datë kur djali i deputetes figuronte në fakt i pranishëm në një konflikt me armë në Gjirokastër.

Vërtetimi i lëshuar nga Psikiatriku i Elbasanit e shpëtoi djalin e deputetes nga akuza për armëmbajtje pa leje në ngjarjen e ndodhur në Gjirokastër. Sipas të dhënave zyrtare mësohet se Pjerin Xhuvani ka qenë për disa vjet drejtor i spitalit Psikiatrik të Elbasanit, ndërsa që nga viti i kaluar drejtonte zyrën e Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Dhe sot, Konstandin Xhuvani ndodhet në burg për masakrën e Gjirokastrës ndërsa Pjerin Xhuvani u vra në një ngjarje të rëndë në Elbasan, ende e pazbardhur.

15:05 - Arma në Elbasan! Në gjendje të rëndë për jetën Klemend Xhaferri, pjesë e sherrit me simpatizantët e PD në Elbasan

Klemend Ymer Xhaferi është një nga personat që ka mbetur i plagosur ditën e sotme në Elbasn. Po ashtu të plagosur kanë mbetur dhe disa persona të tjerë, ndërkohë që viktimë ka mbetur Pjerin Xhuvani. Partia Demokratike e akuzoi Pjerin Xhuvanin dhe Klemend Xhaferin si eksponent të krimit që u përfshi në sherrin mes mbështetësve të Partisë Demokratike dhe atyre të Partisë Socialiste, Ditën e Verës në Elbasan, kur në bulevard po kalonte kryeministri Edi Rama.

15:05 - Vetëm 100 metra larg zyrës së PD-së! Vrasja që tronditi Elbasanin, pak më tutje ishin mbledhur demokratët

Vrasja e Pjerin Xhuvanit ka ndodhur vetëm 100 metra larg zyrës elektorale të PD-së së zonës. Burime për **Dosja.al** bëjnë me dije se nga vendi ku është shtrirë kufoma, disa metra më tutje ndodhej sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi. Ky i fundit ka shkuar i pari në vendin e krimit për të parë nga afër çfarë kishte ndodhur.

14:44 - Vendi rrethohet nga ambulanca dhe forca të shumta policie! Dalin pamjet e para nga ekzekutimi i Pjerin Xhuvanit në Elbasan

Kanë dalë pamjet e para nga vendi ku u egzekutua Pjerin Xhuvanit. Ngjarja ka ndodhur vetëm pak minuta më parë në mes të qytetit të Elbasanit. Në videon e mëposhtëme shuhet se vendi është rrethuar nga ambulanca, forca të shumta policie dhe dhjetra njerëz.

14:58 - **Del EMRI: Kjo është efektivja e "Shqiponjave" që u plagos në Elbasan, u ndodh aty dhe...**

Foto ilustruese

Zbulohet identiteti i efektives së plagosur në vrasjen e Pjerin Xhuvanit në Elbasan. Burime për **Dosja.al** bëjnë me dije se efektivia e forcave "Shqiponja" është Xhensila Shota. Mësohet se e reja ndodhej në zonë në momentin kur është shtënë me armë zjarri.

14:57 - **Gazment Bardhi tregon çfarë ndodhet brenda makinës së Pjerin Xhuvanit: Ka para dhe karta identiteti, ky është shtabi elektoral i Taulant Ballës**

Drejtuesi politik i Partisë Demokratike në Elbasan dhe personi që identifikoi Pjerin Xhuvanin në Elbasan në përplasjen e 14 marsit, Gazment Bardhi, ka folur menjëherë pas ngjarjes. Bardhi ishte një nga personat që pa menjëherë situatën pas ngjarjes dhe për mediat lokale ka dhënë detajet e para. Bardhi është shprehur se në makinën ku u vra Pjerin Xhuvani kishte brenda para dhe karta identiteti.

"Është një makinë e mbushur plot me para. Aty i kishit, ti kishit kapur, kapeni me median. Nuk kam shumë informacion, makina që shikoni atje është e mbushur me karta identiteti dhe para e drejtuar nga prej eksponentëve të krimit të organizuar dhe trupin e shihni vetë atje. Kaq kam për të thënë, janë një grup personash, shtabi elektoral i vërtet i Taulant Ballës."-tha Gazment Bardhi.

14:49 - **Vrasja e Pjerin Xhuvanit! Drejt Elbasanit forcat RENEA, Ardi Veliu dhe Tonin Vocaj**

Drejt Elbasanit janë nisur forcat RENEA, Ardi Veliu dhe Tonin Vocaj.

14:48 - **"Bardhi ndaloi makinën me para"/ Cili ishte roli i demokratit në Elbasan,**

tregoi para kamerave ç'pa brenda makinës së viktimës...

Vrasja e Pjerin Xhuvanit ka tronditur sot qytetin e Elbasanit. Fillimisht u raportuar se ishte sekretari i Përgjithshëm, Gazmend Bardhi ishte personi që ndaloi një makinë të mbushur me para, dhe pas ishin dëgjuar të shtëna por demokrati jep një version tjetër.

Gazetarët kanë raportuar se Bardhi nuk ka pasur lidhje me rastin por është lejuar që të kalojë dhe të shohë nga afër skenën e krimit, pa u penguar nga forcat e Policisë. Ndërsa ka treguar se brenda mjetit kishte karta identiteti dhe para. Por ende nuk ka një version zyrtar të tij lidhur me ngjarjen.

14:50 - **Ekzekutimi i Xhuvanit në Elbasan! Një nga të plagosurit dhëndri i viktimës, në gjendje të rëndë për jetën!**



Pamje nga vendi i ngjarjes

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga ekzekutimi i Pjerin Xhuvanit në Elbasan. Një nga të plagosurit dhëndri i Pjerin Xhuvanit, ndodhet në spital në gjendje të rëndë.

14:45 - **VIDEO/ Momenti, ja kur Pjerin Xhuvani përplasej me simpatizantët e PD në Elbasan! Si u bënë bashkë disa eksponentë të krimit për të goditur ata që bërtitën "Rama ik"**

Viktima e ngjarjes së rëndë që ka ndodhur sot në Elbasan është Pjerin Xhuvani, një emër i njohur për qytetarët dhe politikën shqiptare. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur pas një sherri që ka nisur në lagjen "5 Maji" në Elbasan. **Por kur është hera e fundit që iu dëgjua emri Xhuvanit në media?**

Partia Demokratike e akuzoi Pjerin Xhuvanin si një nga eksponentët e krimit që u përfshi në sherrin mes mbështetësve të Partisë Demokratike dhe atyre të Partisë Socialiste, Ditën e Verës në Elbasan, kur në bulevard po kalonte kryeministri Edi

Rama. Ai është akuzuar edhe për laboratorin e drogës në Xibrakë të Elbasanit, ndërsa është njohur si aktivist i PS-së.

14:43 - **I MBULUAR me COPË TË KUQE, pamjet e kufomës së Pjerin Xhuvanit, Policia e ka rrethuar...**

Dalin pamje nga vendi i ngjarjes, ku viktima Pjerin Xhuvani është shtrirë në tokë pasi është qëlluar me armë zjarri mbi 20 herë në mes të qytetit të Elbasanit.

Siç duket edhe nga pamjet, viktima është mbuluar me një copë të kuqe dhe kufoma është i rrethuar nga efektivët e Policisë së Shtetit.

14:37 - **Vrasja e Pjerin Xhuvanit! Dyshimet e para, ish-efektivi i RENEA-s autori i 56-vjeçarit**

Pamje nga vendi i ngjarjes

Një ish-efektiv i Reneas dyshohet se është autori i ekzekutimit të Pjerin Xhuvanit në Elbasan. Policia është në ndjekje të autorit të ngjarjes së rëndë.

14:36 - **VIDEO/ Kush është Pjerin Xhuvani, eksponenti i krimit që u bë pjesë e sherrit të ditës së Verës në Elbasan ku u përplasën mbështetësit e PD dhe PS**

Pjerin Xhuvani

Një vrasje ka tronditur mesditën e sotme Elbasanin, ndërsa ende shkaqet janë të paqarta. Burime për ***Dosja.al*** bëjnë me dije se është ekzekutuar Pjerin Xhuvani, një emër i njohur në qytetin e Elbasanit dhe në të gjithë Shqipërinë. Ai ishte duke lëvizur në zonën e lagjes "5 Maji", kur është qëlluar me breshëri dhe ka ngelur i vdekur në vend.

Por kush është Xhuvani?

Dosja.al verifikoi dhe zbuloi se Pjerin Xhuvani është i njëjti person i cili u përfshi në sherrin mes mbvështetsve të Partisë Demokratike dhe asaj Socialiste në Elbasan ditën e verës. Xhuvani ka qenë disa vite më parë drejtues i Lëvizjes Socialiste për Integrim, ndërsa tashmë në vitet e fundit ishte angazhuar pranë Partisë Socialiste.

Xhuvani ka qenë ish- drejtor në Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, dhe është prangosur 6 vite më parë pasi akuzohej se i shkaktoi dëm rreth 56 milionë lekë të reja shtetit. Më 14 mars ai ishte pjesë e turmës që goditi mbështetësit e PD të cilët thërritën Rama ik gjatë parakalimit të kryeministrit Edi Rama.

14:34 - **Edhe një "Shqiponjë" i plagosur? Ç'ka ndodhur në Elbasan, dyshohet për një polic në spital**



Detaje të tjera janë mësuar nga ngjarja e ndodhur në lagjen "5 maji" në qytetin e Elbasanit. Dyshohet se i plagosur ka mbetur një efektiv i forcave "Shqiponja", dhe ndodhet në spital, por nuk dihen detaje lidhur me gjendjen e tij shëndetësore. Deri më tani bëhet me dije se në vendin e ngjarjes janë dëgjuar mbi 20 të shtëna.

14:31 - **Ekzekutimi i Pjerin Xhuvanit në Elbasan! U dëgjuan më shumë se 20 të shtëna**

Pamje nga vendngjarja

Pjerin Xhuvani është vrarë mesditën e sotme në Elbasan. Xhubani është vrarë me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar. Nga burimet bëhet e ditur se janë dëgjuar më shumë se 20 të shtëna me armë.

13:40 - **Incident në Elbasan! Ndalohet mjeti që shpërndante para, njerëzit: U dëgjuan të shtëna**

Foto ilustruese

Një mjet i cili dyshohet se shpërndante para është ndaluar ditën e sotme në qytetin e Elbasanit. Mësohet se mjeti i shpërndante paratë në lagjen '5 Maji'. Sipas qytetarëve janë dëgjuar dhe disa të shtëna. Por nuk dihet motivi i shpërndarjes së shumës të së ardhurave dhe numrin ekzakt të tyre.

ETIKETA: #elbasan #Pjerin Xhuvani #vritet Pjerin Xhuvani

34
SHARES

Previous article
Karteli i Meksikës përdori dronë shpërthyes për të sulmuar policinë, plagosen dy oficerë

Next article
Ekzekutimi i Pjerin Xhuvanit në Elbasan! U dëgjuan më shumë se 20 të shtëna

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME


Aktualitet

U arrestuan LIVE! Djemtë e prangosur në Elbasan janë përfshirë në sherrin e 14-Marsit,...


Aktualitet

Artan Hoxha jep 'alarme të forta': Ajo që pamë në Elbasan, mund të ndodhë në Shkodër e...

Aktualitet

"Jam i gatshëm të përballem", Klodiana Lala tregon telefonatën me të...

Aktualitet

Masakra në Elbasan, Artan Hoxha: Xhuvani lajmëroi njerëzit e tij, vrasja ndodhi në sy të...

dosja.al
ME RITMIN E NGJARJES

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

info@dosja.al +355 682676444

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :
Kejsi Muça
Riviera Gjyli
Alberta Boseta
Kleida Muka
Orgeta Likaj
Florida Mingla
Dezdemona Kolaveri
Izmir Akulli
Daniela Andrellari

© 2021 Dosja. Të gjitha të drejtat e rezervuara.